



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 3/901

Datë: 10 / 11 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kompetencave të përcaktuara në nenin 20, si dhe në zbatim të nenit 46, pikës 1.4 të Statutit të UP-së, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas Rregullores nr. prot: 650, të datës 27.3.2025, për studimet e doktoratës - formularëve përkatës, si dhe konkursit me nr. prot. 2/46, të datës 03.09.2025, të shpallur nga Universiteti i Prishtinës për pranimin e studentëve në studime të doktoratës për vitin akademik 2025/'26, në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** rekomandimi i Këshillit Qendror për Studime të Doktoratës për miratim të listës përfundimtare të kandidatëve për pranim në studime të doktoratës në vitin akademik 2025/'26, sipas propozimit të Fakultetit të Mjekësisë.
- II. Kandidatët e pranuar në studime të doktoratës për vitin akademik 2025/'26 do të regjistrohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
- III. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (Ndërtesa e Bibliotekës Qendrore Universitare).
- IV. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili shkarkohet nga SEMS-i);
 - Dy fotografi të formatit 6x4cm;
 - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga SEMS-i);
 - Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste.
- V. Data e fillimit të ligjëratave caktohet nga njësite akademike përkatëse.
- VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe lista e kandidatëve të pranuar, përkatësisht lista me nr. prot: 9251, e datës 15.10.2025 e Fakultetit të Mjekësisë.

- VII. Obligohet njësia akademike përkatëse që këtë vendim ta publikojë në uebfaqen e njësisë akademike.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

A r s y e t i m

Këshilli Qendror për Studime të Doktoratës (KQSD), në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2025, ka shqyrtuar Raportin e Fakultetit të Mjekësisë lidhur me realizimin e konkursit për studime të doktoratës me nr. 2/46, të datës 03.09.2025, për vitin akademik 2025/2026, në programin Stomatologji.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar — raportit për ecurinë e konkursit, raportit të Komisionit të Ankesave, si dhe listës preliminare të rezultateve të kandidatëve — KQSD-ja konstatoi se procesi është zhvilluar në përputhje me dispozitat normative përkatëse.


Në bazë të pikës 4 të nenit 7 të Rregullores për studime të doktoratës, KQSD-ja ia paraqet Senatit për vendimmarrje Raportin me nr. 9251, të datës 15.10.2025, të Komisionit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2025/2026 në programin Stomatologji në Fakultetin e Mjekësisë.

Senati i Universitetit të Prishtinës, mbështetur në argumentet e sipërshënuara, bazuar dhe në rekomandimin e KQSD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund të parashtrojnë ankesë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit në uebfaqen e universitetit. Palët, ankesën e drejtojnë në njësinë akademike përkatëse, pastaj njësia akademike përkatëse e procedon ankesën pranë Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia të Senatit të UP-së.*

Vendimi t'u dërgohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike përkatëse;
3. Departamentit për Çështje Ligjore;
4. Departamentit për Buxhet dhe Financa;
5. Departamentit për Çështje Akademike;
6. Arkivit të UP-së.



Kryesues i Senatit të UP-së,

Arben Hajrullahu

Prof. Arben Hajrullahu, rektor